

VENDIM
Nr. 304, datë 10.5.2019

**PËR PËRJASHTIMIN NGA DETYRIMI PËR PAJISJE ME LEJE PUNE DHE
CERTIFIKATË REGJISTRIMI NË PUNË PËR SHTETASIT E MALIT TË ZI DHE
TË MAQEDONISË SË VERIUT, TË PËRKATËSISË ETNIKE SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 71, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfashtimin nga detyrimi për pajisje me leje pune apo certifikatë regjistrimi në punë, për shtetasit e Malit të Zi dhe të Maqedonisë së Veriut, të përkatësisë etnike shqiptare, që janë me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë. Këta shtetas gëzojnë të drejtën e punësimit e të vetëpunësimit, sikurse edhe shtetasit shqiptarë, përjashtuar rastet kur punësimi lidhet posaçërisht me pasjen e shtetësisë shqiptare, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Deklarimi për punësimin e shtetasve, sipas përcaktimit të pikës 1, të këtij vendimi, bëhet në zyrën përkatëse të punësimit nga vetë shtetasi apo nga punëdhënësi i tij.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe strukturat në varësi të saj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama